



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, 28 prill 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Gjylnaze Syla, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.

Munguan: Sadik Idriz dhe Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati.

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Nga KDI: Rrezarta Ahmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Rita Hajzeraj, zv.kryetare e parë e Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Teuta Hadri - Tha se propozimin për amendamentimin e titullit të Projektligjit e ka bërë deputetja Nurishahe Hulaj, ndërsa propozimi i deputetes Rita Hajzeraj është vetëm modifikim i propozimit të deputetes Nurishahe Hulaj. Konsideroi se duhet të ruhet autorësia e propozimamendamentit, pavarësisht nga modifikimet që mund të bëhen.

Rita Hajzeraj - Tha se propozimamendamenti i saj dallon nga propozimamendamenti i deputetes Nurishahe Hulaj, prandaj edhe figurojnë si dy amendamente të ndara.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Rita Hajzeraj – Tha se grupi i punës është takuar dhe e ka amendamentuar Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. Propozimamendamente kanë paraqitur edhe deputeti Riza Smaka dhe deputetja Qamile Morina. Këto amendamente i ka shqyrtuar grupi i punës. Raportin për propozimamendamentet e grupit të punës do ta paraqesë deputeti Bujar Bukoshi.

Bujar Bukoshi - Bëri prezantimin e propozimamendamenteve:

Amendamenti 1

Në preambulë, paragrafi 3 të riformulohet:

„Me qëllim të vendosjes dhe të aplikimit të dispozitave ligjore për dhënien e lejeve për punë shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës”.

Amendamenti 2

Titulli i Ligjit të ndryshohet si vijon: „,

“Ligji për dhënien e lejes për punë dhe për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës”.

Amendamenti 3

Neni 1 të riformulohet:

„Ky ligj rregullon mënyrën, kushtet dhe procedurat e dhënies së lejes së punësimit për shtetasit e huaj në Republikën e Kosovës, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, me konventat ndërkombëtare të punës dhe me marrëveshje ndërshtetërore”.

Amendamenti 4

Paragrafi 2 i nenit 2 hiqet.

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.2 hiqet fjala „ *motive* “ dhe zëvendësohet me fjalën „ *qëllime* “.

Amendamenti 6

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.3, pas fjalës „*personi*” shtohen fjalët „*apo grup personash*“

Amendamenti 7

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.4, pas fjalëve „*aktet nënligjore*”, hiqet fjalia në vazhdim .

Amendamenti 8

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.5, hiqet fjala „*këtë*”.

Amendamenti 9

Titulli i nenit 4 të riformulohet:

„Politikat për dhënien e lejes së punës për shtetasit e huaj”

Amendamenti 10

Neni 5, paragrafi 1, hiqet fjalët *”mbi 3 muaj”* dhe zëvendësohen me fjalët *“ së paku 3 muaj”*.

Amendamenti 11

Në tërë tekstin e Projektligjit të hiqet fjala *„aplikueshme”*.

Amendamenti 12

Në nenin 11, paragrafi 1, pika 1.1, pas fjalëve *“këtë punësim”* shtohet fjalia *“ dhe kjo rregullohet me akt nënligjor”*.

Amendamenti 13

Në nenin 13, paragrafi 1, pika 1.4, pas fjalëve *„drejtor ekzekutiv“* hiqen fjalia *„ dhe punonjës të rëndësishëm ‘*.

Amendamenti 14

Në nenin 13, paragrafi 1, pika 1.5, hiqen fjalët *„punonjës dhe”* dhe pas fjalës *„profesionistët“* hiqet fjala *„ të tjerë”*.

Amendamenti 15

Në nenin 18, pas fjalëve *„lëshimit të lejes së punës “* të hiqet teksti në vijim.

Amendamenti 16

Në nenin 21, paragrafi 5 riformulohet si vijon:

“Kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për dhënien e lejes së punës nga parag. 1 i këtij neni, shtetasi i huaj, mund të iniciojë konflikt administrativ”.

Amendamenti 17

Titulli i nenit 22, të riformulohet *„ dispozitat ndëshkimore ‘*.

Amendamenti 18

Në nenin 22, në paragrafët 1 dhe 2, në të tri gjuhët, fjala *„gjobat“* zëvendësohet si vijon:

Në gjuhën shqipe fjala *“Gjobat”* zëvendësohet me *“ dënime me të holla”*.

Në gjuhën angleze fjala *“Penalties”* zëvendësohet me *“Fine”*.

Në gjuhën serbe fjala *“Kazne”* zëvendësohet me *“Novćane kazne”*.

Amendamenti 19

Në nenin 22, paragrafi 1, hiqet *„ 500 deri në 1.500“* dhe zëvendësohet me *„ 1.500 deri në 3.000”* dhe në paragrafin 2 hiqet *„200 deri 500”* dhe zëvendësohet me *„ 500 deri në 1.000 ‘*.

Amendamenti 20

Në nenin 24, paragrafin 1, në rreshtin e pestë dhe të gjashtë, hiqet fjala „*këtij*„

Amendamenti 21

Neni 24 paragrafi 2 të hiqet.

Amendamenti 22

Në titullin e nenit 26, hiqet fjala „*i drejtë*“ dhe në fund të nenit hiqet fjalia „*drejtë dhe efikas të*”

Amendamenti 23

Neni 27, të hiqet.

Kryesuesja i ftoi anëtarët e Komisionit të votonin për propozimamendamentet e paraqitura nga deputeti raportues, Bujar Bukoshi, lidhur me Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Kryesuesja konstatoi se komisioni i miratoi amendamentet e propozuara.

3. Të ndryshme

a) Diskutim rreth “Gripit të derrave”

Nurishahe Hulaj – Propozoi që Komisioni ta vizitojë Ministrinë e Shëndetësisë për çështjen e “*gripit të derrave*” për të parë sa jemi të përgatitur për këtë grip.

Mimoza Ahmetaj – Lidhur më çështjen e “*gripit të derrave*” propozoi që Komisioni ta vizitojë Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni do të vizitojë Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

b) Diskutim rreth Raportit për monitorimin e Ligjit për veprimtari private në shëndetësi

Qamile Morina – Tha se e ka analizuar raportin e Ministrit të Shëndetësisë lidhur me Raportin e Komisionit për monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi. Ajo tha se e ka hartuar një dokument me komente përkitazi me përgjigjet e Ministrit të Shëndetësisë. Propozoi që Komisioni ta analizojë këtë dokument dhe t`i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin do t`i njoftojmë se disa gjëra të paraqitura në atë raport nuk korrespondojnë fare me gjendjen e identifikuar nga Komisioni.

Gjylnaze Sylja – Tha se në parim e mbështet propozimin e deputetes Qamile Morina. Nëse ndonjëri nga anëtarët e Komisionit ka për të shtuar diçka, mund ta bëjë. Ky është një komunikim intern me Ministrinë e Shëndetësisë.

Flora Brovina – Tha se pajtohet me idenë që komisioni t`i japë përgjigje ministrit të Shëndetësisë lidhur me Raportin për monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi.

Nurishahe Hulaj – Tha se në seancën plenare kemi propozuar që Raporti me rekomandime i Komisionit dhe komentet përkitazi me ato rekomandime të ministrit të bashkohen si një material i vetëm.

c) Diskutim rreth takimit me UNICEF-in

Mimoza Ahmetaj – I njoftoi anëtarët e Komisionit për pjesëmarrjen e saj dhe të deputetes Nurishahe Hulaj në takimin e organizuar nga UNICEF-i, lidhur me Ligjin për pasurimin e miellit me hekur dhe me substanca të tjera. Qëllim është mbrojtja e popullatës nga sëmundje të ndryshme. Komisioni për Shëndetësi dhe Komisioni për Bujqësi duhet ta përkrahin këtë nismë. Me pasurimin e miellit me hekur pritet të harxhohen 500 mijë euro nga buxheti i Kosovës, ndërsa pritet të kursehen 10 milionë euro nga barnat dhe nga trajtimet mjekësore të pacientëve.

d) Diskutim rreth takimit me UNDP-në

Mimoza Ahmetaj – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur për pjesëmarrjen e saj dhe të deputetes Qamile Morina në takimin e organizuar nga UNDP-ja për “*Letrën e bardhë*”- sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë. Komisioni për Shëndetësi nuk e ka trajtuar fare këtë çështje, përderisa komisionet e tjera e kanë bërë këtë. Në takim kam propozuar të formohet një grup pune nga tre anëtarë nga secili komision i përfshirë, për të përgatitur dhe për të ndërhyrë aty ku e konsiderojmë të nevojshme. Propozoi që në mbledhjen e radhës Komisioni ta ketë në rënd dite këtë temë.

Nurishahe Hulaj - Tha se “*Letra e bardhë*” lidhet me objektivat e mijëvjeçarit dhe Qeveria është e detyruar të raportojë në Kuvend se çka është dhe çka nuk është realizuar në kuadër të objektivave të mijëvjeçarit.

Flora Brovina – Si anëtare e Komisionit ndihem e mënjanuar ose e papërfillur, kur është fjala për një dokument shumë të rëndësishëm, sepse Komisioni përkatësisht kryesia e komisionit nuk ka organizuar takim me rend dite pikërisht me temën “*Letra e bardhë*”. Kjo lidhet edhe me bashkëpunimin ndërparlamentar, që e ka nisur UNDP- ja, që Kuvendi i Kosovës ta ketë një grup përfaqësues që komunikon me parlamentet evropiane. Kam njohuri se UNDP-ja nuk është e kënaqur as me përfaqësim gjinor- partiak, as me përfaqësim profesional.

Pas diskutimeve të deputetëve komisioni nxori këtë

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të caktohen tre deputetë që të marrin pjesë në grupin e punës për shqyrtimin e “Letrës së bardhë”.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv.Kryetare e Parë Komisionit

Rita Hajzeraj